



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:089769  
Datë: 21.06.2024  
Numri i dokumentit: 05842945

**PAKR.nr.280/2024**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi - kryetar, Bashkim Hyseni dhe Xhevdet Abazi - anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, në lëndën penale kundër të akuzuarve E.M dhe B.M për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vetëgjyqësia nga neni 410 paragrafi 2, lidhur me nenin 31, të KPRK-së, dhe të akuzuarit E.M për shkak të veprës penale përdorim i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 par.2 KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e ushtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit E.M, av.Alban Makolli të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.177/19, datë 20.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPRK-së, më 19.06.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuara ankesa e mbrojtësit të akuzuarit E.M , av.Alban Makolli, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.177/19, datë 20.03.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m i**

Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda me aktgjykimin PKR.nr.177/19, datë 20.03.2024, në pikën I të dispozitivit të akuzuarin E.M , për shkak të veprave penale përdorim i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 par.2 KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumën prej 500 € (pesëqind), të cilën gjobë është i obliguar të e paguaj në afat prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të e merr formën e

prerë si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1(një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 2 (dy) viteve, (afati i verifikimit), nuk kryen vepër tjetër penale.

Në dënimin e shqiptuar më kusht të akuzuarit do të i llogaritet koha e kaluar në arrestin shtëpiak dhe atë prej datës 19.06.2013 deri më 19.11.2024.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohen në format tjera të parapara me nenin 43 paragrafi 3, të KPRK-së, dënimi i caktuara me gjobë do të i shndërrohet në dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 euro, të akuzuarit do të i llogaritet një ditë burgim.

I dëmtuari: T.A. T, në mundësinë hetuese te veçantë ka deklaruar se nuk paraqet kërkesë pasurore juridike.

Është obliguar i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30€ (tridhjetë euro), si dhe të paguaj shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro), në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit.

Në piken II të dispozitivit ndaj të akuzuarve E.M dhe B.Mkonform nenit 362 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, të KPPK-së, ka refuzuar akuzën sepse me datë 19.06.2013, në Prishtinë, Lagja ‘‘Ulpiana’’, afër restorantit ‘‘G..’’, pasi të pandehurit E.M dhe B.M, paraprkisht ia kishin dhënë të dëmtuarit T.A. T, ... (...) €, në emër të biznesit mes të dëmtuarit – T.A.T, shokut të tij të ashtuquajturit B.. dhe të akuzuarve, me të vërejtur të akuzuarit se paratë e tyre ishin zhdukur, duke menduar se i dëmtuari i ka mashtruar dhe nuk do të mund të bëjnë biznes sepse shoku i tij B... kishte ikur dhe kishte marrë të gjitha paratë e lartcekura me vete, të akuzuarit në vend se ti drejtohen organeve kompetente, e kanë ndjekur të dëmtuarin dhe kur e kanë zënë, të akuzuarit kanë përdorur forcën ndaj të dëmtuarit, i akuzuari E.M e ka goditur me grushte, ndërsa i akuzuari B.M e ka mbajtur dhe ia ka marrë dokumentet personale të dëmtuarit si dhe 100€ (njëqind euro).

Me të cilat veprime në bashkëkryerje do të kryenin veprën penale, Vetëgjyqësia, nga neni 410 paragrafi 2, lidhur me nenin 31, të KPRK-së.

Pasi që Prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Shpenzimet e procedurës penale për këtë pjesë të aktgjykimit bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

Mbrojtësi i të akuzuarit E.M , av.Alban Makolli, për shkak të shkeljes se ligjit penal, me propozimin që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoj ankesën dhe ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarin ta liroj nga akuza.

Prokurori i Apelit me parashtrësën, PPA/I.nr.262/2024, datë 15.05.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit E.M , av.Alban Makolli, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-së, në të cilën ka marrë pjesë vetëm mbrojtësi i të akuzuarit E.M , av.Alban Makolli, kurse Prokurori i Apelit dhe të akuzuarit E.M dhe B.M edhe pse kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt nuk morën pjesë në seancë. Mbrojtësi i të akuzuarit E.M , av.Alban Makolli, pasi elaboroi ankesën thekson se qëndron pran pretendimeve ankimuar të ushtruar me shkrim me propozim që i akuzuari të lirohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 394 të KPP-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar

Mbrojtësi i të akuzuarit E.M , av.Alban Makolli, në ankesë thekson se nuk është kontestuese gjendja faktike, se i pandehuri E.M ka shtënë me armë në drejtim të qiellit, vetëm një herë, dhe atë vetëm përgjatë momentit kur ishte duke e ndjekur personin T.A.T, veprim ky i bërë me qëllim që T.A.T të ndalet, dhe që i pandehuri E.. ta neutralizoj dhe vendosë nën kontroll të njëjtin derisa të arrijë Policia. Po ashtu nuk është kontestuese se personi T.A.T dhe një person i tretë (i ashtuquajtur B... nga i pandehuri E.M kishin marrur shumë prej ... Euro, dhe se i pandehuri E.. me pas ka ndërmarre veprime për të mbrojtur pasurinë e tij, në atë mënyrë që e ka ndjekur për ta vënë në kontroll personin T.A, respektivisht siç Gjykata i ka konsideruar si të vërtetuara veprimet lidhur me veprën penale vetëgjyqësia nga neni 410 par.2 të KPRK-së, mirëpo veprimi i të shtënës me armë në drejtim të qiellit, përgjatë ndjekjes e sipër të personit T.A.T, ka qenë njëri nga veprimet, prej tërësisë së veprimeve të ndërmarra nga i pandehuri E.M për të mbrojtur pasurinë e tij, nga veprimet e paligjshme të personit T.A.T i cili i kishte marrë shumë prej 43.000.00 Euro, andaj ky veprim është dashur që të cilësohet në kuadër të veprimeve përkitazi me veprën

penale vetëgjyqësia nga neni 410 par.2 i KPRK-së për të cilën është refuzuar akuza. Pasi që personi T.. kishte sulmuar pasurin e të pandehurit përmes lajthimit dhe mashtrimit dhe lidhur me këtë i është referuar komentari mbi Kodit Penal të Kosovës duke e cituar sulmin si të kundërligjshëm dhe në kuadër të kësaj thekson se të gjitha veprimet e ndërmarra nga i pandehuri E.M , janë bërë me qëllim të mbrojtjes se pasurisë së tij, dhe janë në proporcion të plotë me sulmin në drejtim të pasurisë së tij, ku i njëjti ka qenë në ndjekje e sipër të personit T.A dhe meqë ky i fundit ishte duke ikur përmes vrapimit me shpejtësi të lartë, në pamundësi që ta ndjekë të njëjtin, kishte shtënë vetëm një herë për ta frikësuar me qëllim që personi T.A.T të ndalej, pra as nuk kishte shtënë më tepër se një herë, e as nuk kishte shtënë në drejtim te personit T.A.T edhe pse fare lehtë kishte mundur që ta bënte një gjë të tillë, dhe në momentin kur kishte arritur që ta neutralizonte dhe vendoste në kontroll derisa të arrinte Policia, i pandehuri E.M nuk kishte shtënë në drejtim të personit T.A.T.

Mbështetur në këto fakte, rezulton se në veprimet e të pandehurit E.M përkitazi me të shtënë me arme dhe me këtë kryerjen e veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së, rezulton se manifestohen rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale, ngase vepra është kryer në mbrojtje të nevojshme dhe se në veprimet e të mbrojturit tim nuk manifestohet përgjegjësia penale, andaj Gjykata pa të drejtë nuk ka zbatuar nenin 12 par. 1 dhe par.2 të KPRK-së, duke shkelur kështu ligjin penal.

Ka shtuar se nga faktet e vërtetuara, rezulton qartë se nuk është manifestuar qëllimi dhe dashja që i pandehuri E.M të shtij me armë e me këtë të konsumoj elementet që përbëjnë figurën ligjore të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së, por se ky veprim, ishte i imponuar, i pashmangshëm dhe i bërë me të vetmin qëllim që personi T.A.T të kapej dhe te vendosej nën kontroll derisa të arrinte Policia.

Se qëllimi i vetëm ishte ky, u vërtetua nga fakti se i pandehuri E.. kishte shtënë me armë vetëm përderisa ishte duke e ndjekur personin T.A.T, kurse ky i fundit ishte kishte shtënë vetëm një herë me armë, dhe në momentin që kishte arritur ta kap- ta neutralizojë dhe vendosë nën kontroll derisa të arrinte policia, asnjëherë nuk kishte shtënë me arme duke e nxjerr në pah qëllimin dhe dashjen e vërtetë, e që nuk ishte dashja për ta përdorur armën, por dashja për ta nxënë dhe vendose nën kontroll të dëmtuarin T.A.T.

Në ndërlidhje me nenin 17 par. 1, të KPRK-së, Gjykata e Shkallës së Parë është dashur që të ketë në konsideratë edhe neni 160 kur një person kapet në flagrancë, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

### **Vlerësimi i Gjykatës së Apelit**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtën e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë aspekt konform nenit 394 par.1 të KPPK-së, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin prishjen e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate ( pasi që nuk mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore ngase i akuzuar e ka pranuar fajësinë, kurse aktgjykimi u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore sa i përket shkeljes se ligjit penale dhe vendimit mbi dënim.

### **Pretendimet ankimore lidhur me shkeljen e ligjit penal**

Pretendimet e mbrojtjes se në rastin konkret nuk ekzistojnë elementet e veprës penale përdorim i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 par.2 KPRK-së, pasi që veprimi i të shtënës me armë në drejtim të qiellit, përgjatë ndjekjes e sipër të personit T.A.T, ka qenë njëri nga veprimet, prej tërësisë së veprimeve të ndërmarra nga i pandehuri E.M për të mbrojtur pasurinë e tij, nga veprimet e paligjshme të personit Tito.T Amede Taboue i cili i kishte marrë shumën prej 43.000.00 Euro, andaj ky veprim është dashur që të cilësohet në kuadër të veprimeve përkitazi me veprën penale vetëgjyqësia nga neni 410 par.2 i KPRK-së për të cilën është refuzuar akuza.

Janë pretendime të pa bazuara dhe nuk paraqesin arsye për shkelje të ligjit penal, nga fakti se nga provat e administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe nga vetë deklarimi i të akuzuarit i cili i ka pranuar veprimet e ndërmarra në lidhje me përdorimin e armës, është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i njëjti në me veprimet e tij ka konsumuar veprën penale përdorim i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 367 par.2 KPRK-së, për të cilën vepër penale edhe është shpallur fajtor dhe dënuar si në dispozitiv të aktgjykimi të ankimuar, prandaj veprimet e ndërmarra nga ana e të akuzuarit nuk mund të konsumohen me veprën penale vetëgjyqësia për të cilin prokurori i

shteti kishte hequr dore për shkak të parashkrimi absolut, mbi këto arsye nuk ka shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit.

#### Të gjeturat lidhur me vendim mbi dënim

Edhe pse aktgjykimi i ankimuar nuk është atakuar për vendim mbi dënim, kjo gjykatë të njëjtin e shqyrtoj sipas detyrës zyrtare dhe ka gjetur se Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësisë së dënimit në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese për të akuzuari ka vlerësuar faktin se i njëjti më parë nuk është gjykuar me vendim të formës së prerë, pra është hera e parë që i akuzuari ka rënë ndesh me ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese ka vlerësuar shkallën dhe peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, faktin se i njëjti armën e ka bartur me vete dhe atë në veturën e tij, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të akuzuarit i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të aktgjykimi, me bindjen se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjeneralë, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanat e kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të akuzuarit.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, andaj të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit edhe të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**PAKR.nr.280/24**  
**Datë: 19.06.2024**

**Bashkëpunëtorja profesionale,**

---

**Syzana Goxhuli**

**Kryetar i kolegjit,**

---

**Burim Ademi**

**Anëtarët e kolegjit:**

**Bashkim Hyseni**

---

**Xhevdet Abazi**

---